

Thirrja është e hapur nga data 05.01.2026 deri më 15.01.2026

TERMAT E REFERENCES

THIRRJE PËR OFRIMIN E SHËRBIMEVE MEDIALE PËR PROJEKTET TË IMPLEMENTUARA NGA OJQ “NEVO KONCEPTI”

Të dhënat mbi OJQ “Nevo Koncepti” dhe kërkesat për shërbimet nga kompanit.

Organizata	OJQ “NEVO KONCEPTI”
Objektiva	Ofrimi i shërbimeve mediale për realizimin e aktiviteteve në kuadër të projekteve të cilat implementohen nga OJQ Nevo Koncepti.

1. TË DHËNAT MBI ORGANIZATËN

OJQ “Nevo Koncepti” është organizatë joqeveritare e themeluar më 26 Nëntor 2014. Në themelimin e OJQ “Nevo Koncepti” kanë marrë pjesë intelektualë të komunitetit Romë të cilët për shumë vite janë angazhuar në forma të ndryshme dhe kanë kontribuar në fuqizimin dhe avancimin e pozitës së komunitetit Rom në pjesë të ndryshme të Kosovës sikurse në Prizren, Gjakovë, Ferizaj, Pejë, Rahovec, Fushë Kosovë, Suharekë etj.

OJQ “Nevo Koncepti” bashkëpunon me fëmijë, të rinjë dhe familje të komuniteteve Romë, Ashkali dhe Egjiptian, me institucionet publike qendrore dhe lokale, organizata të shumta vendore dhe ndërkombëtare, media dhe palë tjera me interes.

Aktualisht OJQ “Nevo Koncepti” është duke zbatuar 5 projekte në fusha të ndryshme të cilat synim themelor kanë fuqizimin dhe përmirësimin e pozitës së komunitetit Romë, Ashkali dhe Egjiptian.

2. DETYRAT DHE PËRGJEGJËSITË

- Ofrimi për realizimin e debateve të ndryshme me fëmijët dhe institucionet.
- Ofrimi për transmetimin e kampanjave të ndryshme në kuadër të projekteve.
- Ofrimi i qmimit të volitshëm për realizimin e debateve dhe transmetimin e kampanjave.
- Sigurimi i faturës në momentin e blerjes me të dhëna të OJQ-s.

2. AFATI KOHOR

Realizimin e debateve, transmetimin e kampanjave, përcjellja e ngjarjeve (aktiviteteve), do të bëhet sipas planit të paraparë të projekteve të OJQ “Nevo Koncepti”

3. REZULTATET E PRITSHME

- Bashkëpunim të mirë në mes OJQ-s dhe kompanisë përfituese.
- Përgjigjja në kohë me dokumentacione përcjellëse pas blerjes si fatura.

PROCEDURA E APLIKIMIT

Aplikacionet duhet të dërgohen duke përfshirë këto dokumente:

- Oferta
- Kopja e regjistrimit të biznesit me numër unik identifikues

Aplikimi duhet të dërgohet jo më larg se data **15.01.2024** në emailin prokurimi@nevokoncepti.org apo në formë fizike në selin e OJQ''Nevo Koncepti'' në adresen Rr.Adnan Krasniqi hyrja II nr.8 Prizren.